



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1612/11 prot.

Datë 13.08.2025

V E N D I M
Nr.1051/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.08.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.993/2025, datë 31.07.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur – e thjeshtuar” me nr. Ref-48315-05-20-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 8,250,000.00 lekë, pa tvsh, zhvilluar në datën 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë.

Shfuqizimi i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” PF, në procedurën e prokurimit të sipërcituar si dhe lënien e të skualifikuar të operatorëve të tjerë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Vasaa” shpk me nipt J62903470T, adresa: L. Kryengritja e Fierit.

Autoriteti kontraktor:

Ndërmarrja e shërbimeve publike Sarandë, Adresa: Rruga “Adem Sheme”, Sarandë.

Subjekti interesuar:

Operatori ekonomik “Ervin Luzi”pf, me nipt K71707007Q, me adresë : Tiranë, Kashar Yrshek, Lagjia Katund i ri, Rruga “Ali Pash Gucia”, godina nr. 5.

Operatori ekonomik “Mifeel” shpk me nipt L82916601N me adresë : Gjirokastër Lagjia "18 Shtatori studenti " objekti nr 27/6.

Operatori ekonomik “Nika Trading Sa” shpk me nipt M13817805J me adresë: Vlore, Sarandë, Lagjia nr.4, Rruga Idriz Alidhima, godina nr.5, kati parë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 31.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 993/2025, ku vendosi:

1.Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vassa” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur – e thjeshtuar” me Nr. REF-48315-05-20-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per mirembajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 8,250,000.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë.

2.Autoriteti kontraktues të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Vassa” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “Vassa” SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 106/1 prot., datë 08.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1612/08 prot., datë 12.08.2025, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 993/2025, datë 31.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E Hapur – e thjeshtuar” me Nr. REF-48315-05-20-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per mirembajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 8,250,000.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 106/1 prot., datë 08.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1612/08 prot., datë 12.08.2025, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 993/2025, datë 31.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E Hapur – e thjeshtuar” me Nr. REF-48315-05-20-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per mirembajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 8,250,000.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, konkretisht raportit të auditit, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka bërë rivlersimin e procedurës në sistem mbi zbatimin e vendimit nr. 993/2025, datë 31.07.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë ka zbatuar vendimin nr. 993/2025, datë 31.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi pasi ka rivlerësuar procedurën e prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) në përputhje me konstatimet e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur – e thjeshtuar” me Nr. REF-48315-05-20-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per mirembajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 8,250,000.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

